

BIBLIOTEKA
SHTETIT

81H-7

A 45

BARDHYL AJAZI

MOZAIK HUMORISTIK



vjersha

B1H-7

A43.

BARDHYL AJAZI

**MOZAIK
HUMORISTIK**

- vjersha satirike
- fabula
- epigrame
- epitafe



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»


SHKËNDIJA NGA METALURGJIA

Nga gryka e furnaltës
vërshoi i kuq zjarr
çeliku i parë shqiptar
e xixa shumë lëshoi,
sa armiqtë i verboi.

Një shkëndijë i ra tek flinte fashistit në
ballë:

— Oh, mama mia,
sa dukuri e rrallë,
se nuk ka mundësi
të shkrihet çelik në Shqipëri!
E ku, në Elbasan,
kjo është shaka, se e mbaj mend mirë,
atje s'kishin as ç'të hanin,
as bukë misri me shëllirë.
Një femër s'pata parë në atë djallo qytet,
ku hiqej varfëria, ku nxinin ferexhetë.

Kujtime ku m'u zgjuat dhe gjakun më
bëtë ujë,
kujtova ferexhenë, që pas i rashë dikur!



Sytë për t'i parë.

Por, ah, medet, nagantën ajo më vuri në
ballë

dhe në s'vdiqa atë ditë,
me vrau sot kjo xixë!

Një tjetër shkëndijë ra mbi një eses

— Jo, kjo grimcë, me siguri
është pluhur kozmik,
se nuk ka absolutisht mundësi,
që atje në Shqipëri

të prodhohet çelik!

E kam ndërmend atë që quhet Elbasan,
dukej nga ajo e mallkuar Kërrabë,
ku autokolonat tona ranë në lak,
në lakun e tmerrshëm partizan,
e tërë atë të mallkuar rrugë me zigzage
e lamë me kocka dhe tanke,
nga ca palo dyfegje.

Kurse tani me kryqet tona dhe me
helmetat,

fëmijët stolisin dordolecët,
ndaj them se kjo xixë, që duket në
Elbasan,

në qoftë e vërtetë,
do të më djegë si një shafran!

Po, Shqipëria prodhoi edhe çelik,
prodhoi bukë, prodhoi gaz dhe dritë.
Të tëra shpresat e tyre shkuan dhe vanë,
shpresat revizioniste e fashiste kudo që
janë,


se ja, shqiptarët grurë dhe barut
të bollshëm dhe të thatë e kanë me grusht,
edhe ky zjarr çeliku i vuri pikë
në pluhur dhe hone u shkrinë demagogjitë,
se analiza foli pa mëshirë:

— Çelik i markës më të mirë!

E u shpërndanë xixa anembanë,
mbi disa si bomba të fuqishme,
por mbi miq edhe mbi shokë
si lule të kuqe nga toka socialiste.

Q O S H J A J O N Ë

Si në stadium,
ku miqtë, pasi ulen vetë
në vendet me biletë
e një andej e një këndej mundohen,
tek shtyjnë njëri-tjetrin dhe shtrëngohen,
që t'i bëjnë vend shokut që rri në këmbë,
ashtu shokët dhe miqtë mua më bëjnë
vend në një zyrë.



Ngushtë ishim në fillim,
po u zgjeruam,
morëm një tavolinë, raft, komplet për
shkrim,
pastaj disa dhoma në zyra i shndërruam
dhe unë u ngushtova prapë
(megjithëse bënte vapë)
kërkova një shok
të punonim tok
në një tavolinë, në qoshk.
Por... këtë herë
kontrolli punëtor na trokiti në derë
dhe... për nder,
në ndërgjegje na trokiti.

Zëri i masës
na zgjoi,
na përtëriti.
Prandaj në mbledhje morëm zotim
unanim:
Të zbresim në prodhim!

KËSHILLA E SHPËRDORUESIT

— Kurseni mallin, shokë, kurseni,
hidhni sytë rrotull, ku vemi?
Këto tulla të thyera,
këto dyer të shqyera,
këto eternite e xhama të bërë copë,
këto dërrasa, që kalben përtokë,
këto hekura të ndryshkura,
këto tuba të shtrëmbëruara,
ky llaç dhe këto arka të harruara,
këto trarë dhe shtylla betoni...
Të gjitha ç'i shikoni
nëpër shesh e s'jua vrasin sytë,
janë mall me vlerë,
që s'kanë të blerë!
Kështu, siç i keni lënë, haptazi duhet
thënë,
(siç tha dhe shoku shef)
ky s'është kursim,

por thjeshtë, shpërdorim,
që duhet t'jua bëjmë ngarkim!
Prandaj, që të mos na ndodhë një gjë e
tillë

dhe unë të mos prish gojë,
dëgjoni një këshillë:
Përplasini të gjitha
në një qoshe larg sheshit,
që të mos i shohin kurrë
sytë e shefit!